

PRANVERA TELI (DIBRA)

PAKTI I DYTË I TIRANËS, NËNTOR 1927, NË POLITIKAT RAJONALE BRITANIKE*

“Shqipëria, problemi i Adriatikut”

Në korrik të vitit 1927, Foreign Policy Association (FPA) në Londër, do të prezantonte për publikun britanik e jo vetëm, një analizë të hollësishme diplomatike me titull “Shqipëria, problemi i Adriatikut”. FPA argumentonte që “Në qendër të luftës diplomatike që po zhvillohet ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë është kontrolli i Adriatikut dhe konkretisht dominimi politik në Shqipëri”.¹ Sipas kësaj analize, ky krahasim i gjatë i Mesdheut, që kishte hyrë thellë në masivin tokësor të Evropës për të ndarë Italinë nga Ballkani, kufizohej nga tre shtete politike, por ishte dalje natyrale për tregtinë e 5 shteteve. Italia, Jugosllavia dhe Shqipëria zinin brigjet e tij kryesore, ndërsa Austria dhe Hungaria që shtriheshin më në veri, përtej Italisë dhe Jugosllavisë, nuk kishin humbur krejtësisht lidhjet e vjetra me të. Një pjesë e tregtisë së tyre akoma gjente dalje natyrale në Adriatik. Interes në Adriatik paraqitnin edhe Polonia, Bullgaria, Rumania dhe Greqia për llogari të afërsisë së tyre me Adriatikon. Dalja në Adriatik përmbledhte shumë interesa shtetesh, por të gjendura përballë njëra-tjetrës në brigjet e një deti të ngushtë, Italia dhe Jugosllavia, që në fund të Luftës së Parë Botërore ishin konkurrentet kryesore në betejën për të marrë kontrollin e Adriatikut. Nga të dy konkurrentet, Italia gëzonte pozicion më të fuqishëm. Ajo zotëronte më shumë porte e baza detare në Adriatik, bregdet më të gjatë, kontrollonte linjat detare e ajrore trans-Adriatike. Interesat italiane në Adriatik ishin më të vjetra se ato jugosllave, të cilat filluan të shfaqen pas shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze në fund të Luftës së Parë Botërore.

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Rrugëtimi i shtetit të pavarur shqiptar nga krijimi drejt integritit evropian”, organizuar nga Instituti i Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë, më 27 nëntor 2017.

¹ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Public Record Office (më tej: *PRO*), Foreign Office (më tej: *FO*), 371/12071, C5783/4815/90. Foreign Policy Association, vol. III, No. 8, 22 qershor 1927.

Qeveria jugosllave e dinte mirë dobësinë e saj para një Italie ambicioze në ngjitje, aq më tepër pas ardhjes së partisë fashiste në pushtet në Romë.

Në pranverë të vitit 1927, marrëdhëniet midis Italisë e Jugosllavisë po përjetonin një periudhë tensioni në rritje. Në nëntor 1926, Italia kishte shpallur përfundimin e Paktit të Miqësisë dhe Sigurisë me Shqipërinë, shtetin e ri dhe të dobët ekonomikisht, por me pozitë të rëndësishme gjeostrategjike në brigjet lindore të Adriatikut, ndaj të cilit Konferenca e Ambasadorëve 1921, pas një këmbënguljeje të gjatë nga ana e Italisë, kishte njohur interesat e veçanta të saj në stabilitetin ekonomik e politik të tij. Ky pakt, i njohur ndryshe si Pakti i Parë i Tiranës shënonte ndarjen e plotë dhe përfundimtare të Zogut nga Jugosllavia dhe Shqipëria bëhej kryeurë e Italisë në Ballkan.² Autoritetet jugosllave besonin që Pakti i Parë i Tiranës, ashtu siç ishte hartuar, synonte vendosjen e një protektorati italian mbi Shqipërinë, që do thoshte një mbizotërim i dukshëm i Italisë në Adriatik, e si i tillë përbënte një rrezik për sigurinë e saj. Jugosllavia nuk ishte e vetme në këtë shqetësim. Në pak muaj Pakti shkaktoi stuhi diplomatike në kancelaritë e Francës, Britanisë e Gjermanisë, që do të thoshte ai prekte disa interesa konfliktuale në rajon.³ Fuqitë e Mëdha, veçanërisht Britania e Madhe, në kuadër të politikave të saj të ruajtjes së paqes dhe ekuilibrave të vendosur në Evropë në përfundim të Luftës së Botërore, përpiqej të shmangte sa mundej dominimin e një fuqie evropiane në zona të ndryshme të kontinentit, aq më tepër në një rajon me histori konfliktesh, siç ishte Ballkani.

Përkundrejt shqetësimit të qeverisë jugosllave* ndaj rreziqeve që paraqiste për sigurinë e Jugosllavisë Pakti i Parë i Tiranës, në mars 1927 marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve hynë në një krizë të dytë. E nxitur nga alarmet që vinin nga Tirana zyrtare mbi qëllimet e emigracionit politik jashtë vendit për rrëzimin e Ahmet Zogut nga pushteti, qeveria italiane vuri në dijeni Britaninë e Madhe, Francën dhe Gjermaninë se kishte prova që Jugosllavia ishte përfshirë në një valë mobilizimi të shpejtë ushtarak me qëllim që të pushtonte Shqipërinë. Jugosllavia mohoi çdo akuzë nëpërmjet legatës së saj në Londër, duke sqaruar se nuk po kryhej asnjë lloj përgatitjeje ushtarake me qëllim cenimin e kufijve të Shqipërisë dhe as të Italisë. Beogradi zyrtar madje propozoi krijimin e një komisioni

² Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 414.

³ TNA, PRO. FO 371/12071, C5783/4815/90. Foreign Policy Association. Information Service.

* Qeveria e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene e formuar më 1918.

ndërkombëtar neutral për të vëzhguar kufirin shqiptaro-jugosllav, të përbërë nga përfaqësues të tri Fuqive të Mëdha, dhe nga përfaqësues të Italisë dhe Jugosllavisë. Qeveria italiane nuk pranoi propozimin jugosllav duke e quajtur fyerje ndaj saj faktin që Evropa diskutonte vërtetësinë e informacioneve dhe argumenteve që sillte Roma zyrtare. Meqenëse nuk gjeti reagimin që priste në kancelaritë evropiane, Musolini deklaroi se falë sigurive që ofronte Pakti i Parë i Tiranës, rreziku kishte kaluar, si rrjedhojë ky komision nuk funksionoi asnjëherë.⁴

Për të normalizuar marrëdhëniet ndërmjet Romës dhe Beogradit, Londra e Parisi propozonin zhvillimin e bisedimeve të drejtpërdrejta midis tyre, ku të dy palët të moderonin qëndrimet e tyre politike. Ata sugjeruan arritjen e një kompromisi ku nga njëra anë Jugosllavia të ratifikonte marrëveshjen e arritur me Italinë në nëntor 1920 mbi statusin e Fiumes dhe hinterlandit të saj⁵, ndërsa Italia të angazhohej publikisht ose privatisht që nuk do të shfrytëzonte Paktin e Parë të Tiranës për të ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë. Musolini reagoi menjëherë ndaj këtij sugjerimi që ai e konsideronte si ndërhyrje në punët e brendshme të shteteve sovraane, duke argumentuar se për sa kohë Pakti i Tiranës ishte nënshkruar nga Italia dhe Shqipëria në ushtrim të plotë të sovranitetit të tyre dhe nuk drejtohej kundër asnjë shteti tjetër, çështja e rikonsiderimit të tij nuk mund të hapej në asnjë tavolinë bisedimesh. Kjo deklaratë rrëzoi përpjekjet e ndërkombëtarëve për të gjetur qetësi në Adriatik, e veçanërisht në një zonë delikate të tij, siç ishte Shqipëria. Ministri i Jashtëm francez Briand, propozoi një traktat trepalësh Paris-Romë-Beograd, ku Franca merrte përsipër rolin e moderatorit, por Musolini e hodhi poshtë këtë propozim⁶. Asnjë nga përpjekjet për të zgjidhur me frymën e pajtimit përplasjet italo-jugosllave për dominim politik në Shqipëri e në Adriatik, nuk po funksiononte në këtë pjesë të Evropës.

Roma dhe Beogradi vazhdonin të akuzonin njëra-tjetrën për përgatitje ushtarake, për harta të marra nga austriakët, për rritje të prezencës ushtarake italiane në Shqipëri etj. Sa më tepër ashpërsoheshin akuzat e ndërsjella aq më tepër Londra zyrtare kërkonte rrugë

⁴ TNA, PRO. FO 371/12847, C2191/2191/90, Annual Report: Albania 1927, Durrës, 5 mars 1928.

⁵ Në këtë marrëveshje Shqipëria dhe statusi i saj nuk do të përdroreshin si mjet kompensimi në diskutimin italo-jugosllav për çështjen e Fiumes.

⁶ A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 415.

diplomatike dhe marrëveshje të gjera për të arritur qetësinë në Adriatik. Pavarësisht përpjekjeve për të gjetur kompromis, ekzistenca e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për Shqipërinë e vitit 1921, investimet e gjera ekonomike italiane në Shqipëri, dobësia ekonomike e politike e saj, nuk jepnin shumë optimizëm se ky konflikt, që përbënte esencën e problemit të Adriatikut, do të eliminohej.

Nëpërmjet Paktit të Parë të Tiranës Italia synonte të forconte pozitave të Ahmet Zogut. Stabiliteti i pozitave të tij i interesonte edhe Londrës zyrtare, pasi çdo largim i tij do të shtronte çështjen e trashëgimisë së pushtetit dhe do të aktivizonte presione të reja të huaja në këtë vend. Sipas Foreign Office, "...italianët duke mbajtur Ahmet Zogun, përpiqen të mbajnë Shqipërinë larg shqetësimeve që mund të kalojnë nga sfera lokale jashtë saj, pra është dora e fortë e Zogut që mban këtë vend bashkë nga shpërthimet që priten në pjesë të ndryshme të tij", konstatonin diplomatët britanikë⁷. Qeveria britanike kishte deklaruar se njihte interesat italiane në Shqipëri, por nuk njihte influencën ekskluzive apo të drejtën e ndërhyrjes së Italisë në Shqipëri. Në momentin e tensionimit të marrëdhënieve italo-jugosllave për shkak të Paktit të Parë të Tiranës, në shtator 1927, Sekretari i Shtetit Chamberlain, shkëmbeu nota verbale në kanale diplomatike me Musolinin. Nëpërmjet tyre ky i fundit ishte shprehur se Italia kishte të drejtën të mbronte çdo regjim politik miqësor ndaj Italisë në Shqipëri, madje edhe kundër opozitës së brendshme. Ky qëndrim i Musolinit, që praktikisht do të thoshte ndërhyrje në administrimin e brendshëm të Shqipërisë, u mor seriozisht në konsideratë në Londër pasi i binte drejtpërdrejtë ndesh qëndrimit të saj zyrtar. Në këndvështrimin e diplomacisë britanike, meqenëse në praktikë nuk kishte alternativë tjetër ndaj qeverisjes së Ahmet Zogut dhe rënia e kësaj qeverie mund të thoshte rrezikim i pavarësisë së Shqipërisë për shkak të ndërhyrjes nga jashtë, u vendos përfundimisht që të mos kundërshtohej sfida e Musolinit, por të pranohej në heshtje pretendimi i tij. "Parandalimi i një lufte ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë për llogari të Shqipërisë është objektiv kryesor dhe i fundit i politikës tonë në Shqipëri-deklaronte Chamberlain- dhe ne mund të ndryshojmë qëndrimin tonë ndaj ndërhyrjes italiane në Shqipëri vetëm nëse kjo justifikon realizimin e objektivit tonë atje. Në qoftë se ne i japim dorë të lirë Italisë në Shqipëri,

⁷ TNA, PRO. FO 371/12068, C6666/946/90. Relacion i Graham në Romë për Chamberlain, FO, 8 gusht 1927.

dhe i lëmë Jugosllavisë të kuptojë se ne kemi hequr dorë nga parimi i pavarësisë së Shqipërisë dhe njohim nevojën për një mandat italian atje, rezultati do të ishte një rritje e frikës dhe dyshimeve jugosllave e cila do të përpiqej vetë e me të tjerë të ndalonte Italinë sa nuk ishte vonë që të kishte një këmbë në Ballkan, e kjo nuk duhet të ndodhte.”⁸

Nga ana tjetër, në një plan më të gjerë Italia përpiqej të përjashtonte Francën nga Ballkani. Kjo e fundit duke besuar pak tek sistemi i sigurisë që ofronte Lidhja e Kombeve, përpiqej të zgjeronte rrjetin e saj të aleancave dypalëshe kudo ku mund të kërcënohej siguria e saj. Nga ana tjetër, për ballkanasit Franca nuk përfaqësonte një shtet që kishte plane territoriale në rajon dhe kështu ajo gëzonte simpatinë e tyre, veçanërisht të Beogradit zyrtar.⁹

Për shkak të një mirëkuptimi më të gjerë me Italinë në çështje të tjera të mëdha ndërkombëtare, Britania ishte e ndërgjegjshme për interesat italiane në Shqipëri, prandaj politika e saj ishte deri diku pasive, për të mos thënë nguruese, jo se binte dakord me qëndrimin italian në Shqipëri, por sepse nuk gjente arsye praktike për t’i rezistuar Musolinit. “Është pranuar nga të gjithë –analizonte Foreign Office- që Shqipëria duhet të mbështetet diku. E vetmja alternativë ishte Lidhja e Kombeve ose ndonjë fuqi e madhe që në rrethanat e krijuara është Italia. Duhej që Lidhja e Kombeve ta mbështeste me një hua ndërkombëtare Shqipërinë që të mos i linte financat shqiptare të binin në duart e Italisë. Kjo nuk ndodhi dhe tani Italia, si anëtare e Këshillit të Lidhjes, vendos veton duke mos e lejuar Lidhjen të veprojë. Nëse Lidhja e Kombeve do i jepte mandat Italisë, kjo do të kundërshtohej nga vetë shqiptarët dhe nga Franca.”¹⁰ Në çdo situatë të krijuar, e vetmja rrugë për britanikët mbetej Musolini duke e udhëzuar në veprimet e tij ndaj Shqipërisë, sikurse duke frenuar ambicien e tij atje, ambicie që prishte ekuilibrat në rajon.

Paktet dypalëshe, kërcënim për ekuilibrat në Ballkan

E pasigurt përballë prezencës në rritje të Italisë në Shqipëri dhe në koherencë me frikën franceze për një dominim italian në Ballkan,

⁸ *Po aty*, PRO. FO 371/12645, C7410/25/90. Analizë e Chamberlain per Sargent, FO, 6 shtator 1927.

⁹ *Po aty*, PRO. FO 371/12068, C6666/946/90. Informacion i Graham për Austen Chamberlain, 8 gusht 1927.

¹⁰ *Po aty*, PRO. FO 371/12645, C7410/25/90. Analizë e Leepe për Sargent, FO, 6 shtator 1927.

Jugosllavia nënshkroi me Francën më 21 nëntor 1921 Aleancën franko-jugosllave. Kjo aleancë u bë një prej pengesave për të përmirësuar në vijim marrëdhëniet italo-jugosllave. Italianët e vlerësuan këtë traktat si një shenjë e jashtme e dukshme e një politike të supozuar për të rrethuar Italinë ushtarakisht e politikisht. Kjo situatë e re ndikoi që marrëdhëniet italo-jugosllave të lidheshin shumë me zhvillimet në marrëdhëniet italo-franceze. Aleanca franko-jugosllave përfaqësonte për Italinë një sfidë, “një lloj sistemi kontrolli mbi veprimtarinë e saj në Ballkan, një lloj detyrimi për Italinë për të moderuar dinamizmin e saj në Mesdhe, sepse nuk do të kishte më sigurinë e mbrojtjes nga Evropa”.¹¹

Në kushtet e reja të krijuara dhe në vazhden e projekteve politike italiane në Shqipëri, italianët po në nëntor të 1927-ës filluan të bënin presion mbi Zogun që të arrinin një aleancë mbrojtjeje ushtarake mes dy palëve. Kjo do të forconte më tej edhe pozitat e Ahmet Zogut në pushtet. I pasigurt në rrugën e propozuar nga italianët dhe i ndërgjegjshëm për pasojat, Zogu kërkoi takim me përfaqësuesin britanik në Durrës, Seed. Në këtë takim Zogu i kërkoi diplomatit anglez të dinte mendimin e tij dhe qeverisë britanike nëse ai duhej të vazhdonte kursin e tij të deriatëhershëm në marrëdhëniet me Italinë, ta forconte atë, apo të ndryshonte tërë politikën e tij. Nga ana tjetër, Zogu nuk i foli aspak atij për aleancën e re që po projektohej nga italianët. Seed e inkurajoi Presidentin me argumentin se kursi i tij politik kishte prodhuar paqe, por nga ana tjetër e këshilloi atë të bënte kujdes me prezencën e forcave ushtarake italiane në Shqipëri e të shmangte hapat që mund të nxisnin frikë e xhelozë në Beograd. Zogu i shqetësuar për rrethanat e krijuara i bëri të ditur diplomatit anglez frikën e tij se Shqipëria ishte një viktimitë e paracaktuar e papajtueshmërisë së plotë të Italisë dhe Jugosllavisë në këtë rajon. Ndaj ai po përpiqej të ndiqte një kurs të sigurt, por e ndjente se ndodhej mbi një vullkan. “Askush nuk e di – përfundon Zogu - se çfarë rrengu mund të luaj me mua Italia apo Jugosllavia”.¹²

Bisedimet me italianët u zhvilluan në fshehtësi të plotë. Përfaqësuesi anglez në Durrës mori dijeni për këto bisedime dhe përgatitjen e një pakti të aleancës ushtarake më 21 nëntor nga përfaqësuesi i Francës në Shqipëri, Baron de Vaux. Informacioni kishte rrjedhur nga ministri i

¹¹ Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane, 1920-1934*, Tiranë: Afërdita, 2002, f. 136.

¹² TNA, PRO. FO 371/12069, C9594/946/90. Informacion i Seed për Chamberlain, 16 nëntor 1927.

Jashtëm Iljaz Vrioni. Bëhej fjalë për një pakt sekret ushtarak midis Shqipërisë dhe Italisë për të cilën Presidenti Zog, nën presionin e fortë italian, ishte nervoz dhe i shqetësuar për ta nënshkruar ose jo. Baroni de Vaux kërkonte ndërhyrjen e qeverisë britanike në këtë çështje sa nuk ishte vonë duke marrë në konsideratë ndikimin që kishte përfaqësuesi britanik Seed tek Ahmet Zogu. Sipas tij, nënshkrimi i kësaj aleance do të çonte në komplikime ndërkombëtare. Tani Seed e kuptoi shqetësimin që Zogu i kishte shprehur para pak ditësh. I bindur se një marrëveshje serioze ushtarake italo-shqiptare nuk mund të nënshkruhej nga Zogu pa dijeninë e tij dhe qeverisë britanike, Seed vendosi në fillim të mos vepronte e të priste zhvillimet në vijim. Por, duke marrë në konsideratë faktin që njoftimi erdhi nga pala franceze, si dhe pasojat që do të kishte kjo situatë tek sjellja e Beogradit zyrtar, Seed vendosi të takonte menjëherë Presidentin e Republikës Shqiptare.¹³

Përfaqësuesi francez në Shqipëri, Baron de Vaux kishte dy ditë që kërkonte një audiencë me Zogun. Ai ishte udhëzuar nga Parisi që të merrte me vete në takim edhe paktin franko-jugosllav për të bindur Presidentin shqiptar për natyrën paqësore të atij instrumenti. Kjo do të ishte një siguri për Zogun që ai të mos nënshkruante aleancën ushtarake me Italinë, por Zogu akoma nuk e kishte pranuar kërkesën e tij për takim. Ndërkohë përfaqësuesi britanik Seed u prit nga Zogu më 22 nëntor brenda pak orëve pas bërjes së kërkesës për audiencë. Në këtë takim Zogu i shpjegoi Seed se “Shqipëria ishte një vend i vogël dhe i dobët që nuk mund të jetonte pa mbrojtjen e një vendi më të fuqishëm”¹⁴. Për herë të parë, ai vuri në dijeni Seed-in se duke u ndjerë i kërcënuar nga traktati franko-jugosllav të nënshkruar pak ditë më parë, ai po bënte një traktat me Italinë”. Më tej, Zogu i tregoi përfaqësuesit britanik për përmbajtjen e tekstit dhe faktin se ai do të regjistron në Lidhjen e Kombeve. William Seed krijoi përshtypjen se Ahmet Zogu dukej krejt i pasigurtë dhe nën presion për çfarë po bënte, ndaj kërkonte indirekt mbështetjen britanike për ta refuzuar aleancën e re ushtarake me Italinë. Zogu u shpreh se në qoftë se Lidhja e Kombeve nuk do ta aprovonte për ndonjë arsye traktatin e ri, ai do ta prishte atë menjëherë, pavarësisht qëndrimit të italianëve.¹⁵

¹³ *Po aty*, PRO. FO 371/12066, C9598/25/90. Informacion i Seed për Foreign Office, Durrës, 21 nëntor 1927.

¹⁴ *Po aty*, PRO. FO 371/12066, C10061/25/90. Informacion i Seed për Chamberlain, Durrës, 23 nëntor 1927.

¹⁵ *Po aty*.

Traktati ishte nënshkruar në mëngjesin e asaj dite, më 22 nëntor 1927. Përballë çudisë së përfaqësuesit britanik që nuk ishte vënë në dijeni para nënshkrimit, Zogu u shfaqësua se i ishte përmbajtur këshillës britanike që të mos kryente asnjë veprim që do të irritonte serbët. Traktati në fjalë kishte natyrë mbrojtëse, e njëjta gjë që kishin bërë edhe jugosllavët me Francën. Por përfaqësuesi britanik e shikonte rrezikun në një situatë më të përgjithshme, tek dy polet që po krijoheshin e që mund të ndiznin rajonin në çdo kohë. Zogu u tregua i gatshëm që të gjente mënyra për të mos ratifikuar Paktin, nëse këtë veprim e këshillonte dhe e mbronte pala britanike.

Diplomacia britanike nuk tregoi shumë shqetësim për përmbajtjen e paktit sesa për kohën e zgjedhur për ta nënshkruar atë. Pakti i ri ishte vazhdim logjik i Paktit të Parë të 27 nëntorit 1926, një zgjerim i mëtejshëm i përmbajtjes së tij duke përfshirë aspektin ushtarak.¹⁶ Foreign Office i kërkoi Zogut që të spostohejshin procedurat e ratifikimit në Parlament dhe asgjë të mos bëhej publike për dy ose tre ditë, me qëllim që t'i jepej kohë qeverisë britanike të komunikonte me Musolinin për një zgjidhje më gjithëpërfshirëse të kësaj situate. Seed porositi Presidentin që ndërhyrja britanike duhej mbajtur e fshehtë nga publiku dhe nga Franca.

Edhe përfaqësuesi italian në Durrës, Sola, ra dakord për këtë shtyrje që t'i jepej kohë palëve të bisedonin, por ai i shpjegoi Seed se ky pakt ishte krejt i ngjashëm me paktin anglo-portugez të 1810-ës. Ndryshe nga Zogu, Sola u shpreh se “..traktati nuk është arritur si një përgjigje ndaj marrëveshjes franko-jugosllave, por me qëllim që të bëhej e qartë dhe e pagabueshme pozita e Shqipërisë. Shqipëria duhet të jetë për Italinë, çfarë Portugalia kishte qenë për Anglinë për një kohë të gjatë, një aleate e pavarur, e sigurt, nën mbrojtjen e një fuqie më të madhe, shtet sovran, e gatshme për t'i dhënë burimet e saj aleancës në rast nevojë. Siç kishte luftuar Anglia për pavarësinë e Portugalisë, ashtu do të vepronte Italia për pavarësinë e Shqipërisë.” Përfaqësuesi britanik nuk e gjeti me vend paralelizmin e bërë pasi sipas tij bëhej fjalë për dy kohë krejt të ndryshme.¹⁷ Musolini nuk ra dakord me qëndrimin britanik dhe këshilloi përfaqësuesin italian në Londër, Bordonaron, që t'i kërkonte Foreign Office që të mos ushtronin presion në Tiranë për mosratifikim të Paktit.

¹⁶ Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, f. 702.

¹⁷ TNA, PRO. FO 371/12066, C10061/25/90. Informacion i Seed për FO, 23 nëntor 1927.

Një rast të tillë Italia do të ishte e detyruar ta konsideronte si jo miqësor, pasi Pakti ishte një pakt paqeje dhe një fakt i kryer.¹⁸

Me të marrë njoftim nga përfaqësuesi i saj në Durrës për këtë situatë të re në rajon, Foreign Office filloi menjëherë përpjekjet diplomatike pranë Romës zyrtare për të shmangur krijimin e dy poleve në rajon, të cilat mund të përplaseshin me njëra-tjetrën për shkak të çdo dobësie apo veprimi të pamatur të qeverisë shqiptare, e cila sipas FO e kishte demonstruar se kishte nevojë të kishte mbrojtje politike dhe ekonomike nga një shtet më i madh.

Në protestën diplomatike që Chamberlain bëri tek Musolini, ai doli me propozimin që një Lokarno¹⁹ ballkanike duhej të aplikohet në rastin e Shqipërisë, si vendi ku përplaseshin interesat italiane e ato jugosllave në rajon. Argumenti i përdorur nga kryeministri Chamberlain ishte fakti që “meqenëse të dy palët interesoheshin për pavarësinë e Shqipërisë, të përfshihej edhe Jugosllavia në aleancën mbrojtëse italo-shqiptare”. Musolini e kundërshtoi këtë propozim dhe la të kuptonte se ky Pakt ishte konsideruar prej tij si një konsolidim i Paktit të Parë të Tiranës, i cili “..nuk dëshironte të shkatërronte pavarësinë e Shqipërisë, por edhe nuk lejonte që ndonjë fuqi tjetër të ishte në një pozicion të tillë që mund të kërcënonte interesat italiane atje”²⁰. Kështu Jugosllavia nuk mund të pranohej të ishte pjesë e një pakti të tillë. Musolini sqaroi britanikët se problemi i paqes midis Italisë dhe Jugosllavisë, që në fakt do të thoshte paqe në Ballkan, ishte në thelbin e vet një problem i politikës franko-italiane në rajon. Ai hodhi idenë e një marrëveshjeje franko-italiane të ndërmjetësuar nga britanikët. Musolini shprehu keqardhjen për situatën e pakënaqshme në të cilën ndodheshin në atë kohë marrëdhëniet franko-italiane, kjo për shkak të regjimeve të ndryshme politike të dy vendeve dhe përplasjeve të interesave në zona të ndryshme gjeografike për çështje të ndryshme.²¹ Ai akuzoi qeverinë franceze për mungesë vullneti të mirë për t’i zgjidhur problemet dypalëshe dhe, në këto kushte i quante pa vend edhe bisedimet me ministrin e Jashtëm Briand. Sipas tij, Jugosllavia

¹⁸ P. Milo, *Politika e Jashtëme e Shqipërisë.....*, f. 703.

¹⁹ Pakti i Lokarnos i vitit 1925 i arritur midis Francës dhe Gjermanisë nën garancinë e Britanisë së Madhe dhe Italisë.

²⁰ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia angleze, 1919-1927*, Tiranë: Neraida, 2005, f. 456.

²¹ TNA, PRO. FO 371/12066, C9688/25/90. Informacion i A.Chamberlain për Graham, FO, 28 nëntor 1927.

inkurajohej nga Franca në çdo situatë problematike që ajo shkaktonte në rajon, ndaj Musolini kërkonte ndërhyrjen e Britanisë së Madhe në këtë rast që marrëdhëniet midis Romës dhe Parisit të normalizoheshin.

Foreign Office i mori me rezerva të gjitha opsionet e Musolinit, i bindur se Franca në kushtet e pasigurisë në të cilën ndodhej dhe natyrën e qëndrimit shumë të moderuar të Briand, nuk nxiste probleme, por mundohej t'i moderonte ato kudo ndodheshin, edhe në rastin e Jugosllavisë e Shqipërisë. Chamberlain refuzoi të ndërmernte në këtë rast rolin e kanalit të komunikimit midis Romës dhe Parisit.²² Ai do të përdorte të gjitha mundësitë e veta vetëm në rastin kur dy shtetet mike të ulura në bisedime do të ndeshnin vështirësi në arritjen e marrëveshjeve dhe duhej ndërhyrja britanike për t'i sheshuar ato. Chamberlain u shpreh se pikërisht pakti trepalësh Itali-Shqipëri-Jugosllavi ishte një ndër mjetet e propozuara nga Londra për t'i sheshuar kontradiktat franko-italiane. Londra zyrtare merrte përsipër t'i propozonte Beogradit shndërrimin e aleancës italo-shqiptare në një traktat trepalësh të garancive reciproke, por kjo ishte refuzuar nga Musolini, duke e bërë të pavlefshëm ndërhyrjen e FO-së. Nëpërmjet përfaqësuesit të tij në Londër, Musolini përsëriste sigurinë e tij se Italia ishte e gatshme për një politikë paqësore në rajon dhe nuk do të bënte asgjë që shqetësonte paqen në Ballkan ose në botë, pasi vetë Italia kishte nevojë për paqe. Duke përcjellë këto deklarata Chamberlain shprehu rezervën e tij se ai besonte në sigurinë që jepte Musolini, por i vinte keq për mjetet që ai kishte zgjedhur për të zbatuar këtë politikë, mjete të zgjedhura keq për qëllimin që kishte në mendje.²³

Pas dështimit për ta shndërruar këtë aleancë dypalëshe në një pakt trepalësh të tipit Lokarno që ofronte garanci reciproke, pas pesë ditësh Seed udhëzoi Ahmet Zogun që të vazhdonte me procedurat e ratifikimit të tij. Dhoma e Deputetëve e Parlamentit Shqiptar ratifikoi unanimisht më 26 nëntor 1927, Paktin e Aleancës Mbrojtëse, i njohur si Pakti i Dytë i Tiranës, dhe më 30 nëntor atë e ratifikoi edhe Senati.²⁴ Zogu në cilësinë e Presidentit të Republikës e dekretoi Paktin më 2 dhjetor 1927. Disa ditë

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*, PRO. FO 371/12066, C9688/25/90. Informacion i A. Chamberlain për Graham - Romë, FO, 28 nëntor 1927.

²⁴ *Po aty*, PRO. FO 371/12066, C10062/25/90. Informacion i Seed për Chamberlain, 30 nëntor 1927.

më vonë edhe në Romë u ndoq e njëjta procedurë. Ratifikimet u shkëmbyen më 24 janar 1928.²⁵

Në pamundësi të bindjes së Musolinit që ky pakt të shndërrohej në një pakt trepalësh të garancive reciproke, FO filloi të shqyrtonte variantin e dytë të rrëzimit të tij në Lidhjen e Kombeve kur ai të paraqitej për regjistrim. Për këtë arsye FO i bëri një analizë të përgjithshme përmbajtjes së tij dhe e gjetën krejt të papajtueshme me shpirtin e Konventës së Lidhjes së Kombeve. Gjatë gjithë tekstit të Paktit palët, edhe pse të dyja anëtare të Lidhjes së Kombeve, nuk i referoheshin fare asaj dhe as detyrimeve të tyre si anëtare të Lidhjes së Kombeve. Këtu ishte edhe dallimi i dukshëm i Paktit me Traktatin e Garancive reciproke të firmosur në Lokarno, më 16 tetor 1925. Asnjë nga palët e lidhura në këtë Aleancë nuk ishte e gatshme të ushtronte të drejtat e saj në Lidhjen e Kombeve. Italia duke qenë anëtare e Lidhjes së Kombeve mund të votonte kundër çdo mase rekomanduese që mund të jepej kundër Shqipërisë, për sa kohë që në nenin 1 të Traktatit të Aleancës, Italia zotohej të mbronte të drejtat e Shqipërisë me të njëjtin zell që do të mbronte interesat e veta. Në fakt mbrojtjen që Italia i ofronte Shqipërisë në rast agresioni nga jashtë, ia ofronte asaj vetë Lidhja e Kombeve si për çdo anëtar, në zbatim të Konventës.²⁶ Pika të rëndësishme të këtij pakti i binin ndesh Konventës së Lidhjes së Kombeve, e cila po humbiste vazhdimisht reputacionin e saj në gjetjen e mënyrave për shmangien e konfliktit. Tani që ndjehej e fuqizuar, për Italinë fashiste kishte pak rëndësi pozicioni i saj në Lidhjen e Kombeve, pasi vetë organizata nuk e ndihmonte në synimet e saj politike, dominimin e sigurt në Adriatik. Diplomacia britanike kishte dështuar për të krijuar një Lokarno Ballkanike, apo një qetësim të Adriatikut. Në një analizë të Foreign Office për Paktin e Dytë të Tiranës vihej në dukje se “Asgjë nuk do t’i shërbente më shumë paqes në Ballkan e Adriatik sesa një marrëveshje Lokarnoje midis Italisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë, e cila do të zëvendësonte instrumentet e pakteve dypalëshe, të cilat me kalimin e kohës mund të çojnë vetëm në një konflikt serioz”²⁷. Për të mos humbur mbështetjen e nevojshme të Italisë në zona të tjera të interesave britanike,

²⁵ P. Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 448.

²⁶ TNA, PRO. FO 371/12066, C9811/25/90. Informacion i Chamberlain për Graham, FO, 5 dhjetor 1927.

²⁷ *Po aty*, PRO. FO 371/12066, C9656/25/90. Koment i Foreign Office për Paktin, 24 nëntor 1927.

qeveria britanike hoqi dorë nga rrëzimi i Paktit në Lidhjen e Kombeve. Më 8 shkurt 1928 ai u regjistrua në Lidhjen e Kombeve.²⁸

E vetmja shpresë për rajonin sipas skemave të diplomacisë britanike mbeteshin rritja e influencës së Lidhjes së Kombeve në Ballkan, forcimi në këtë rajon i parimeve të hedhura në Lokarno dhe përpjekjet e vazhdueshme të Foreign Office për të moderuar sjelljet politike të aktorëve kryesorë të interesuar kur të krijoheshin situata të vështira. Ky do të ishte roli dhe pozicioni i saj në të ardhmen në këtë pjesë të Kontinentit të Vjetër.

²⁸ P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipëris...*, f.703